



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2023:035841

Datë: 08.04.2024

Numri i dokumentit: 05559100

P.nr.57/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjyquese Sabrije Rraci, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurit, A (H) G, nga fsh.S-K.K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale, kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale „mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe i pandehuri F. G nga fsh. S. K.K, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale Sulmi nga neni 181 par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP//II.nr.4/2023, të datës 28.02.2023, në shqyrtimin fillestar publik të mbajtur me dt. 18.03.2024 në praninë e Prokurorit të Shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit, A. G, dhe mbrojtësit të tij i caktuar Ex officio, av.Gani Morina, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë 05.03.2024, të njëjtën ditë gjykata shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 08.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër:

- A. G i lindur me dt..... në fsh. S-K.K, ku dhe tani banon, nga babai H dhe e ëma H e vajzërisë G, Ka të kryer shkollën e lartë të biznesit në Itali, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikuar me numër personal,, i nacionaliteti shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë, rreth orës min., rreth në Klinë, me përdorim të armës dhe gjeste e kanos personin tjetër se do ta privojë nga jeta dhe atë të dëmtuarin F. G, në atë mëyrë që pasi ky i fundit në lokalitetin „Coyoto,, e kishte sulmuar vëllaun e të pandehurit A, i njëjti e nxjerr një armë me gaz nga brezi të cilën ia drejton të dëmtuarit F për çka tek ai shkakton frikë dhe panik.

-me këtë ka kryer veprë penale „kanosje” nga neni 181 par.4 e lidhur me par.2 të KPRK-së.

II.Nga kohë e pacaktuar e gjerë me datën, rreth orës min. Në K, mbanë në pronësi një revole me gaz në shkelje me ligjin për armët neni 5 par.1 dhe atë një pistoletë me gaz ngjyrë e zezë e modelit 92, së bashku me një karikator dhe 3 copë fishek të kal.8 mm , në atë mënyrë që, pasi i pandehuri siguron armën e lartcekur të njëjtën e posedon pa leje gjer me datën 30.12.2022 kur kryen veprë penale të përshtuar si në dispozitivin e dytë të këtij aktvendimi dhe më pas arma i sekuestrohet nga Policia e Kosovës.

Me këtë ka kryer veprë penale „mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve „nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve 4, 7 , 17, 38, 43, 40 pika 1.3, 69 dhe 70 dhe neni 181 par.4 e lidhur me par.2 neni 366 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPRK-së:

GJYKON

DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

I.Gjykata të pandehurit A. G i përcakton, sipas dispozitivit -1- dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen veprë të re penale.

Sipas dispozitivit 2 gjykata i përcakton, dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej një (1) viti, nuk kryen veprë të re penale

Konform nenit 76 të KPRK-së, i shqipton:

DËNIM UNIK

E dënon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) vit e dhjetë (10) muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) vite, nuk kryen vepër të re penale.

II. Dënimi me kusht do t'i revokohet nëse i pandehuri kryen vepër penale brenda periudhës verifikuese prej 1 (një) viti, konform nenit 50 të KPRK-së.

III.OBLIGOHET: I pandehuri qe në emer të paushallit gjyqësor të paguaj 20 (njëzet) €, dhe tarifën për kompenzim të viktimave të krimit shumë në vlerë prej 20 (njëzet) €, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, pasi aktgjykimi të merrë formën e prerë.

IV. Udhëzohet: i dëmtuari H (H) G nga fsh. S, K.Klinë qe kërkesën pasurore juridike ta realizoi në kontest civil.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën, me shenjë PP//II.nr.4/2023 të datës 28.02.2023, ndaj të pandehurit, A (H) G, nga fsh. S-K.K, dhe mbrojtësit të tij të caktuar EX officio av.Gani Morina, i akuzuar për shkak të kryerjes së veprës penale, kanosje nga neni 181 par.4 e lidhur me par.2 të KPRK-së dhe veprës penale „mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht ka bërë VEQIMIN e Procedurës konform nenit 35 të KPPRK-së për të pandehurin, F (Z) G i cili do të merr nr. të ri penal, pasi i njëjti ka qenë i pa arritshëm.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me dt.18.03.2024, gjatë të cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit, Ramiz Buzhala i akuzuari A (H) G dhe mbrojtësi av. Gani Morina. Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i pandehuri pas konsultimit paraprak të mbrojtësit të tij, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale qe i vihej ne

barre, me vie keq për këtë që kam bërë, dhe i njëjti deklaroi se shpreh pendesë për veprën penale të kryer.

Gjykata kërkon mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pasi që i pandehuri pranoi fajësinë dhe ky pranim i fajësisë është bërë me vullnet të lirë dhe pa presion, duke u mbështetur në provat materiale që gjenden në shkresë të lënda. I propozoj gjykatës që të pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale që i vihet në barre, dhe me rastin e marrjes së vendimit, lidhur me dënim, pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethënë lehtësuese.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të pandehurit av. Gani Morina ka deklaruar se pas konsultimit paraprak me të mbrojturin tim, kërkoi nga Gjykata që të ketë lehtësira, me rastin e marrjes së vendimit, duke pasqyruar se i pandehuri nuk është në mardhënie pune, nuk ka dëshmi se ka kryer vepra tjera. Duke marrë parasysh se vet e ka dorëzuar armën-pushkën e gjuetisë, kërkoi nga gjykata që me rastin e marrjes së vendimit të ketë parasysh gjendjen e dobët ekonomike dhe të shqiptoi një dënim më të butë.

I pandehuri kërkoi nga gjykata që të shqiptoi një dënim më të butë pasi që nuk kamë qenë i dënuar më parë, dhe nuk është zhvilluar ndonjë procedurë ndaj meje jetoj në bashkësi familjare prej 13 anëtarë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari i lartcekur, për veprën penale për të cilën është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3.Gjendja faktike e vërtetuar:

Andaj duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata, e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, mbajtje në pronësi kontrollë ose posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale të kanosjes nga neni 181 par. 4 lidhur me par. 2 të KPRK-së,në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

4.Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin, t'a shpall fajtor për kryerjen e veprave penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti e ka kryer veprën penale siç edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtën është përgjegjës. Kjo për faktin se e ka pranuar edhe vet.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit:

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarës Gjukata, i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPK-së.

Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprën penale sikurse më lart, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar,si dhe pendimin e tij, padënueshmërinë e tij më parë, si rrethanë tjetër lehtësuese gjykata muar se i pandehuri vetë e ka dorëzuar vullnetarish pushkën të cilën e ka poseduar pa leje përkatëse, ashtu që gjykatës i ka premtuar se nuk do ta përsërisë më vepra penale. Ndërsa, gjykata sa i përket rrethanave rënduese gjykata për dispozitivin 1 të aktakuzës gjeti dashjen direkte të kryerjes së veprës penale.

6.Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Dënimi me burgim Unik iu shqiptua në kohëzgjatje prej një (1) vit e dhjetë (10) muaj , i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej dy (2) vite, nuk kryen veprën të re penale.

Andaj duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejt, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjykata ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por edhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë e në bazë të neneve 242 dhe nenit 364 dhe KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.57/2023 me datë 08.04.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Fatmire Elezaj

Gjyqtarja

Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:035841
Datë: 08.04.2024
Numri i dokumentit: 05559100